



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



BULETINI DITOR I FSSHM-së

PËRMBLEDHJE INFORMACIONESH NGA LËMIA E SHËNDETSISË TË MARRA NGA SHTYPI DITOR DHE MEDIUMET ELEKTRONIKE

03 Shkurt 2016



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks: 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



FSSH M me dy shërbime të reja elektronike, Ramadani: kjo mundëson proces transparent



Fondi për Sigurim Shëndetësor në kuadër të muajit të shërbimeve elektronike prezantoi edhe dy shërbime të reja elektronike...

Fondi për Sigurim Shëndetësor në kuadër të muajit të shërbimeve elektronike prezantoi edhe dy shërbime të reja elektronike, të cilat do të jenë në shërbim të qytetarëve prej sot, dhe atë: dhënia e propozimit për vazhdimin e pushimit mjekësor dhe raporti për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, si dhe kërkesa elektronike për kompensimin e pagës nga e drejta e pushimit mjekësor dhe pushimit të lehonisë.

“Këto shërbime cilësohen me rëndësi të madhe, pasi mundësojnë proces transparent dhe të drejtë, ashtu që i siguruari, personi i autorizuar i firmës në çdo kohë do të mund t’a ndjekë statusin e kërkesës, të ketë informata deri ku ka arritur procedura e përpunimit të lëndës dhe në rastet kur kërkesa të jetë e miratuar do mund t’a dijnë kur do të realizohet pagesa”-deklaroi drejtori i FSSH M-së, Orhan Ramadani.

Në rastin e parë, plotësimi i të dhënave do të ndihmonte në krijimin e bazës elektronike me qëllim që mjekët amë të kenë qasje në dokumentet e nevojshme të personave të siguruar.

Shërbimi i dytë elektronik ka të bëjë me kërkesën elektronike për kompensimin e pagës nga e drejta e pushimit mjekësor dhe pushimit të lehonisë, i cili do të privilegjojë personat e siguruar edhe personat e autorizuar të firmave.

Ndërsa dokumentet tjera do të jenë në bazën elektronike të të dhënave të Fondit.

Këto shërbime do të jenë në dobi të të gjithë të siguarve, pasi nuk do të jetë e nevojshme që dokumentet të barten në dorë deri tek Njësia Rajonale e Fondit.



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks: 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



Shuma që ka paguar Fondi në vitin 2015 për 25.000 qytetarë është 2,5 miliardë denarë.



Kërkesë elektronike për pushimin mjekësor dhe pushimin e lehonisë si dhe raport për ndërprerjen e përkohshme të punës



Fondi për sigurim shëndetësor ju njoftoi se muaji Shkurt do të shpallet si muaji i shërbimeve elektronike prandaj, Sot Ju prezentojmë dy shërbime të reja elektronike:

1. Dhënia e Propozimit për vazhdimin e pushimit mjekësor (ΠCP) dhe Raporti për ndërprerjen e marrëdhënies së punës (ИCP)
2. Kërkesë elektronike për kompensimin e pagës nga e drejta e pushimit mjekësor dhe pushimit të lehonisë

Me shërbimin e parë elektronik Ju mundësojmë mjekëve amë që të siguroarve të tyre të Ju japin Propozim për vazhdimin e pushimit mjekësor (ΠCP) dhe Raport për ndërprerjen e marrëdhënies së punës (ИCP). Plotësimi i këtyre të dhënave do t'a krijojnë bazën elektronike në

Fond, e cila do tju shërbejë mjekëve të komisionit të kenë qasje në dokumentet e nevojshme të personave të siguar.

Shërbimi i dytë elektronik ka të bëjë me Kërkesën elektronike për kompensimin e pagës nga e drejta e pushimit mjekësor dhe pushimit të lehonisë. Krahas këtij shërbimi do Ju jepen privilegje personave të siguar edhe personave të autorizuar të firmave. Fillimisht i siguruari/personi i autorizuar i firmës duhet që jetë i regjistruar në portalin e Fondit (të ketë profil personal) dhe të jetë i autorizuar nga ana e Fondit. Personi i autorizuar i cili e parashtron Kërkesën për pushimin mjekësor ose pushimin e lehonisë do të duhet t'i plotësojë vetëm të dhënat e llogarisë rrjedhëse të Bankës respektivisht, llogarinë rrjedhëse të të punësuarit për të cilin bëhet Kërkesa. Ndërsa dokumentet tjera do t'i kemi në bazën elektronike të të dhënave të Fondit. Autorizimi i personave të autorizuar të firmave mund të merret në web faqen zyrtare të Fondit, të plotësohet dhe të dorëzohet në mënyrë elektronike në Fond.

http://www.fzo.org.mk/WBStorage/Files/Obrazec_EL-ZO1.pdf

Këto shërbime cilësohen me rëndësi të madhe pasi mundësojnë proces transparent dhe të drejtë ashtu që i siguruari/ personi i autorizuar i firmës në çdo kohë do mund t'a ndjekë statusin e Kërkesës, të kenë informatë deri ku ka arritur procedura e përpunimit të lëndës dhe në rastet kur Kërkesa të jetë e miratuar do mund t'a dijnë kur do të realizohet pagesa.



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



Këto shërbime do të jenë në dobi të të gjithë të siguruarve pasi nuk do të jetë e nevojshme që dokumentet të barten në dorë deri tek Njësija rajonale e Fondit.

Kushtet Ligjore për realizimin e të drejtës për kompenzimin e pagës janë:

1. Sëmudja ose lëndimi jashta vendit të punës
2. Lëndimi gjatë orarit të punës ose sëmundje profesionale
3. Mjekimi dhe trajtime mjekësore
4. Kujdesi për fëmijën e sëmurë deri në moshën trevjeçare
5. Kujdesi për anëtarin e sëmurë të familjes së ngushtë mbi moshën trevjeçare, më së shumti deri 30 ditë
6. Shoqërimi i domosdoshëm i personit të sëmurë i cili është udhëzuar për kontroll ose për mjekim jashta vendit
7. Shoqërim i domosdoshëm i fëmijës së sëmurë deri në moshën trevjeçare gjatë periudhës së mjekimit spitalor, më së shumti deri 30 ditë
8. Dhurimi i gjakut, indeve dhe i organeve në bazë vullnetare
9. Izolimi për t'a parandaluar përhapjen e infeksionit

Me shërbimet e reja elektronik i arrijmë këto qëllime:

- Thjeshtësimin e procedurës për Kërkesën e pushimit mjekësor
- Informatë për statusin e Kërkesës në çdo kohë
- Informatë për pagesën e pushimit mjekësor

Përfitimet e pritura prej shfrytëzimit të Kërkesës elektronike nëpërmjet portalit:

- Thjeshtësimi i mënyrës sa i përket dorëzimit të dokumenteve përmes kompjuterit personal
- Zvogëlimi i turmave nëpër sportelet e Njësive rajonale të Fondit
- Informimi i personave të siguruar
- Informatë e saktë dhe lehtë e arritshme për të gjitha llojet e pushimit mjekësor
- Zvogëlimi i sasisë së dokumenteve në formë letre

Shuma që ka paguar Fondi në vitin 2015 për 25.000 qytetarë është 2,5 miliardë denarë.

Fondi për sigurim shëndetësor i Maqedonisë vazhdon të jetë i përkushtuar për personat e siguruar dhe të sigurojë shërbime kualitative shëndetësore.